



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

**Nr. 48 datë 30.10.2020**

**PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TE SHESHIT “RUS I MADH” NË  
SHESHI “HAFIZ SABRI KOÇI”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 30.10.2020, pas shqyrtimit të projektvendimit të ardhur nga Kryetari i Bashkisë, referuar propozimit të një këshilltari, mbështetur në nenin 9 pika 1, nënpika 1.7 shkronja “b”, nenin 54 shkronja “ll”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 3 të ligjit nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, të ndryshuar, shkresës nr. 1391/1 datë 28.3.2019 të Ministrit të Brendshëm “Plani i masave mbi finalizimin e procesit të emërtimeve të qyteteve, bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve, parqeve në Republikën e Shqipërisë dhe paisjen me adresë të shtetasve shqiptarë”, relacionit të paraqitur nga administrata e bashkisë, me 36 vota Pro,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimit të emërtimeve të sheshit “RUS I MADH” në sheshi “HAFIZ SABRI KOÇI”
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

**Sekretar i Këshillit**

  
**Denis Lesha**

**KRYETARE**



  
**Enisela KADIJA**